



KONTROLLI I LARTË I SHETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491; e-mail:klsh@klsh.org.al

Nr. 1229/8 Prot

Tiranë, më 30.04.2016

V E N D I M

Nr. 47, Datë 30.04.2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS ELBASAN "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standarteve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e legjislacionit doganor në procesin e realizimit të të ardhurave doganore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ushtruar në Degën e Doganës Elbasan, për periudhën 01.07.2014-31.12.2016".

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar konstatohet se Dega e Doganës Elbasan rezulton me mosrealizim të treguesve të të ardhurave doganore në masën 17% për 6 mujorin e dytë të vitit 2014, në masën 14% për vitin 2015 dhe rreth 31% për vitin 2016. Faktori kryesor që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave, sipas DDE është kufizimi i nivelit të prodhimit të shoqërisë *KI* me nipt dhe revokimi i magazinës fiskale të kësaj shoqërie e cila ka përfaqësuar 50-60% të të ardhurave doganore të mbledhura në këtë doganë. Këto faktorë ekonomikë nuk janë reflektuar në programimin e planifikimit vjetor nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për Degën e Doganës Elbasan.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr 19-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 1.1. Në periudhat në vijim Dega e Doganës Elbasan të rrisë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për studimin, hartimin dhe programimin e objektivave të pranueshëm nga kjo degë doganore. Autoriteti Doganor Elbasan të bëjnë një punë më të mirë duke zhvilluar më tej marrëdhëniet me subjektet, përmiresimin e kushteve të zhdoganimit dhe zbatimin me korrektesë të legjislacionit doganor me qëllim përcaktimin dhe analizimin e indikatorëve dhe faktorëve të ndryshëm ekonomikë për arritjen e këtyre objektivave.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar rezultoi se në Degën Doganore Elbasan në përfundim të vitit 2016 rezultojnë gjithsej 91 raste me vlerë borxhi në shumën totale prej 419,910 mijë lekë, me një nivel të arkëtimit të borxhit relativisht të ulët, i cili tregon për punën e pamjaftueshme që kanë bërë strukturat e borxhit në këtë degë doganore.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 78-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 2.1. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Elbasan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa konkrete nëpërmjet të një programi të posaçëm për të zgjidhur në rrugë ligjore problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 419,910 mijë lekë nëpërmjet urdhërave të ekzekutimit nxjerrë nga Autoritetet Gjyqësore Elbasan duke angazhur të gjitha strukturat e specializuara për të zbatuar hap pas hapi shpjegimet dhe përcaktimet ligjore të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*”, Udhëzimit nr. 6 datë 23.07.2013 “*Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës*” dhe ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “*Kodit Doganor i Republikës*”

së *Shqipërisë*” i ndryshuar për arkëtimin e shpejtë si dhe për vendosjen e sekuestrove ekzekutive për të gjithë ato subjekte që rezultojnë si debitorë në vlera të mëdha.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se operatorët ekonomik që operojnë në fushën e akcizës me status depozitues të miratuar nuk kanë kryer kalibrime për të gjitha depozitat e silloset me kapacitet mbajtës mbi 10 hektolitra si dhe nuk disponojnë kalimatësat në hyrje dhe dalje të produktit në depozita si dhe në pikën e shitjes, në kundërshtim me procedurën ligjore të shprehur në pikën 3/c, neni 20, ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në RSH*”, të përcaktuara si “*detyrime të depozituesit të miratuar*” për një mbikëqyrje sa më të plotë të magazinave fiskale.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 90-103 dhe aneksin nr. 5 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 3.1. Dega Doganore Elbasan me qëllim rregullimin e situatës së krijuar në zbatim të gërmës (c) të pikës 3, neni 20 të ligjit nr.61, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në RSH*”, të detyrojë depozituesit e miratuar “*të përmbushin të gjitha kërkesat e vendosura nga administrata doganore për të mundësuar mbikëqyrjen e magazinës fiskale*” duke kërkuar kalibrimin e gjithë depozitave, enëve dhe sillosëve si dhe kalimatësive në hyrje dhe dalje të produktit në depozita si dhe në pikën e shitjes dhe të aplikojë sanksione administrative sipas neni 85, Kreu “*Shkeljet në fushën e akcizës dhe sanksionet*”, pika 1.a “*Kundërvajtje Administrative*”, neni 96.1, pika 1 deri në revokimin e autorizimeve të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se kundrejt operatorëve ekonomik që operojnë me aktivitet në fushën e regjimeve ekonomike doganore gjatë aktivitetit të tyre bazuar në kërkesat e përcaktuara në nenin 15, pika 1 e Udhëzimit nr. 1 datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “*Për zbatimin praktik të Rregjimit të Përpunimit Aktiv*” nuk janë kryer verifikime dhe monitorime në ambientet e operatorëve tregtarë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 68-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 4.1 Dega Doganore Elbasan të ngrejë grup pune të përbërë nga doganieri mbikëqyrës i regjimeve dhe specialisti i sektorit të Kontrollit Pas Zhdoganimit për saktësimin dhe verifikimin e koeficientit dhe kartës teknologjike të prodhimit në përputhje me nenin 15, pika 1 e Udhëzimit nr. 1

datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se gjatë importeve të mallrave të natyrës mjete lëvizëse transporti autobetoniere të cilat klasifikohen në kapitullin *87* “Mjetet e Transportit” nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë dhënë autorizime përjashtimi nga detyrimet dhe taksat doganore bazuar në legjislacionin në fuqi. Bazuar në legjislacionin në fuqi përjashtimi i TVSH-së jepet për mallra të natyrës “makineritë dhe pajisjet që janë të lidhura me investimin e kryer” të cilat klasifikohen në Kapitujt *84* dhe *85* të Nomenklaturës së Mallrave sipas ligjit nr. 9461 datë 21.12.2005 “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore” i ndryshuar. Mallra të natyrës “autobetoniere” për të cilat janë dhënë autorizime përjashtimi nga taksat për subjektin “V I” nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave klasifikohen në kreun *87* të NM ku klasifikohen “Mjetet e Transportit” dhe jo në Kapitujt *84* dhe *85* të NM ku klasifikohen “Makineritë dhe Pajisjet” duke sjellë si pasojë detyrime doganore të përjashtuara në shumën 6,899,499 lekë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 68-78 dhe aneksin nr. 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 5.1 Dega Doganore Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të analizojë vlefshmërinë ligjore të autorizimeve të përjashtimit nga detyrimet doganore të importit të lëshuar për subjektin “V I” për mallrat “autobetoniere, pastruese plehrash etj” të klasifikuara në kapitullin *87* “mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonët e hekurudhës ose tramvajit, pjesët dhe plotësuesit e tyre” bazuar në frymën e ligjit nr. 125/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa” në ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, neni 4 shkronja “g”, VKM nr. 180 datë 13.02.2013 pika 1, shkronja “a”, pika 3.1, dhe Ligjit nr 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” neni 56 pika 38/a, VKM nr. 953 datë 29.12.2014 neni 8, pika 1/a dhe 4.1 dhe Aneksi i VKM nr 13, datë 14.01.2015 Aneksi 1/1 dhe kërkesave të ligjit nr. 9461 datë 21.12.2005 “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore” i ndryshuar me qëllim riarkëtimin e detyrimeve doganore të përjashtuara nga pagesa e tvsh-së në shumën 6,899,499 lekë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se gjatë konstatimit të shkeljeve doganore në fushën e akcizës subjekte të caktuar të cilët operojnë me mallra të cilët rregullohen dhe normohen nga fusha e Ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH”, VKM-së nr. 612 datë 05.09.2012 “Për

Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat”, i ndryshuar, shkresës nr. 22844 prot datë 30.09.2014 “Mbi përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto”, VKM-së nr. 200 datë 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur midis MF dhe shoqërive G dhe S.PA” nuk kanë lejuar marrjen e mostrimit nga grupi i kontrollit i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. (Trajtuar më hollësisht në faqen 90-103 dhe aneksin nr. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 6.1. Dega Doganore Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të riuhtrojë kontroll pranë operatorëve tregtarë të cilët nuk kanë lejuar ushtrimin e kontrollit nga autoritetet doganore dhe përveç aplikimit të gjobës administrative të aplikojë dhe të drejtën e ndjekjes penale deri në përmbushjen e plotë të përcaktimeve ligjore sipas shpjegimeve të pikës 2/c të nenit 93 ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH”, i cili përcakton se “*Pengimi dhe moslejimi i ushtrimit të kompetencave nga autoritetet doganore, pavarësisht nga ndjekja penale, dënohet me gjobë në masën 200,000 lekë deri në kallëzim penal*” .

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Elbasan të kërkohet në rrugë ligjore të menjëhershme duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, kontabilizimi dhe arkëtimi i detyrimeve doganore të munguara **në Buxhetin e Shtetit në shumën 42,217 mijë lekë**, në mënyrë analitike nga pika 1-5 edhe sipas anekseve nr. 1 deri nr. 8:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultuan klasifikime tarifore jo në përputhje me rregullat bazë të Nomenklaturës së Harmonizuar të Mallrave në RSH të dalë me ligjin nr 9461 datë 21.12.2005, veprime jo në përputhje me nenet 34-37 të KD dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”, shpjegimeve dhe përcaktimeve të përcaktuara në kërkesat e Shtojcës (Aneksit) 4 të Protokollit të Origjinës si dhe nenit 22.4 të Udhërrëfyesit “*Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale.sipas MTL*” dhe nenit 29, 31, 32, 87, 122, 204, 216 të Kodit Doganor me pasojë të ardhura doganore të munguara në shumën 33,668 mijë lekë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 25-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 1.1. Dega Doganore Elbasan të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe nxjerrjen e detyrimeve doganore dhe sanksioneve

doganore në shumën 33,668 mijë lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e dëmit dhe vjeljen e borxhit doganor për detyrime dhe gjoba doganore sipas aneksit nr. 1 dhe 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.08.2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, ligjit nr 61/2012 “Për Akcizat në RSH”, Ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, VKM nr. 559 datë 24.08.2006 “Për Skemën e shtyrjes së TVSH-së” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1 datë 26.09.2006 të DPD me një vlerë në shumën 328,830 lekë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 82-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 2.1. Dega Doganore Elbasan të kërkojë në rrugë ligjore nxjerrjen e vendimeve administrative në shumën 328 mijë lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e dëmit dhe vjeljen e borxhit doganor sipas aneksit nr. 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.08.2017

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore gjatë mbikqyrjes së regjimeve ekonomike rezultuan veprime që kanë sjelle pasoja në keqadministrim të Regjimeve të Përpunimit Aktiv, shkelje të afateve të mbylljes së autorizimeve, autorizime doganore jo në përputhje me kërkesat e pikës 3.1, të VKM-së nr.180 datë 13.02.2013, ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, VKM-së nr. 559 datë 24.08.2006 ligji nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar për periudhën e juridiksionit të auditimit në shumën 250,000 lekë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 68-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 3.1. Dega Doganore Elbasan të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe nxjerrjen detyrimeve doganore dhe sanksioneve doganore në shumën 250 mijë lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e dëmit dhe vjeljen e borxhit doganor për detyrime dhe gjoba doganore sipas aneksit nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.08.2017

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për procedurat e doganore të subjekteve që operojnë sipas Ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH” u konstatuan veprime të kryera jo në përputhje me gërmën (c) të pikës 3, neni 20 dhe 85 të ligjit nr. 61 datë 24.05.2012 për “Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe veprime jo në përputhje me kërkesat ligjit nr.71/2014 të ndryshuar dhe ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, neni 12, pika (2), shkronja (a) “Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji, miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatës” në shumën 1,919,000 lekë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Rekomandimi 4.1. Dega Doganore Elbasan të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe nxjerrjen e sanksioneve doganore në **shumën prej 1,919 mijë lekë** nga 2 subjekte, sipas aneksit nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e dëmit dhe vjeljen e borxhit doganor.

Deri më 31.08.2017

5. Gjetje nga auditimi Konstatohet se Dega Doganore Elbasan pas marrjes dijeni të rezultateve të Projektraportit të Auditimit dalë me shkresën nr. 1229/6 datë 30.03.2017 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka marrë në konsideratë rekomandimet e lëna për kontabilizime detyrimesh doganore të munguara në procesin e vlerësimit doganor, veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike dhe veprimtarisë doganore në fushën e akcizës dhe bazuar në ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë” ka dalë me vendimarrje administrative duke kontabilizuar një borxh të ri doganor në 37 raste për 24 subjekte në shumën totale 6,052,000 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-103 dhe në aneksin nr. 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 5.1. Dega Doganore Elbasan të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin dhe rikuperimin e vlerës së plotë të borxhit doganor në **shumën prej 6,052 mijë lekë** në mbështetje të shpjegimeve dhe përcaktimeve ligjore të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimit nr. 6 datë 23.07.2013 “Për zbatimin praktik të

procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës” dhe ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë” në 37 raste për 24 subjekte sipas aneksit nr. 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë:

Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Elbasan që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 germa “b” dhe “c” të nenit 57 dhe 58 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59 të ligjit nr. 152/2013:

I Neni 58 germa “b-c”, nga “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 1 muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” shërbimi civil” për nëpunësin civil, si më poshtë:

Z R Z me detyrë doganier i sektorit të klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit fizik pranë Degës Doganore Elbasan

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

-jo në përmbushje me Nenin 5 “Produkte tërësisht të përfutuara” pika (h) “artikujt e përdorur, të mbledhur atje, që përshtaten vetëm për mbulimin

e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për ritrajtim ose që përdoren si mbetje”, të Udhërfyesit sipas Ligjit Nr. 9590, datë 27.07.2006 për ratifikimin e MSA. me shpjegimet dhe përcaktimet e nenit 23 të Kodit Doganor “E drejta e Kontrollit”, të nenit 93 të Kodit Doganor “Verifikimi i Deklaratës”, pikës 2 të nenit 87 të Kodit Doganor “Deklarata me Shkrim”, pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 71 të Kodit Doganor “Kontrolli i mallrave dhe mjeteve”, pikës 142.2 sipas shpjegimeve të Seksionit 4 “Dokumentacionit që shoqëron Deklaratën Doganore” të Titullit 10 “Deklarata Doganore” të VKM nr. 205 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” si dhe nuk është kërkuar pranë Drejtorisë së Origjinës në Departamentin Teknik procedura e verifikimit të dokumentit Deklaratë Faturë ose Dokumentit MSABE sipas rasteve të trajtuar në këtë raport përfundimtar auditimit

II Neni 58 germa “b-c”, nga “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për nëpunësin civil, si më poshtë:

Për **z. F K** me detyrë doganiere e sektorit të përjashtimeve, regjimeve dhe akcizës pranë Degës Doganore Elbasan.

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht në lidhje me mbikëqyrjen e regjimeve doganore

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për praktika doganore të përpunuara nga sektori i përjashtimeve, regjimeve dhe akcizës pranë Degës Doganore Elbasan.

III. Neni 58 germa “c” me “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për nëpunësin civil, si më poshtë:

z I C me detyrë doganier i sektorit të klasifikimit, vlerësimit dhe kontrollit fizik pranë Degës Doganore Elbasan

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2

prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

- për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

IV Neni 58 germa “b” me “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 1 muaj për nëpunësin civil, si më poshtë:

znj M C me detyrë specialiste e sektorit të kontrollit pas zhdoganimit, në Degën Doganore Elbasan

-për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr.19095/2 prot DPD, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar konkretisht:

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore*”, nxjerrë për këtë qëllim që lidhen me vlerësimin doganor të mallrave të për të cilat dalin të dhëna të përditësuara të bursës nga Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe nuk janë rishqyrtuar në bazë të shpjegimeve dhe përcaktimeve të nenit 35 dhe 102 të Kodit Doganor

-për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keq klasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD të trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit të cilat nuk janë nuk janë rishqyrtuar në bazë të nenit 102 të Kodit Doganor

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R